

Shqipria Qka qen? Qesht? e Qdote behet?

Biografia e Sami Frashrit

Sami Frasheri

Sami Frasheri ka lindur ne 1 Qershor 1850, ne Frasher te Permetit. Ai ka qene ideologu kryesor i levizjes kombetare shqiptare, dijetar, shkrimtar dhe publicist. Sami Frasheri ishte zoterues i disa gjuheve te huaja si turqisht, italisht, frengjisht, latinisht, greqishten e re dhe te vjeter, arabisht dhe persisht. Sami Frasheri drejtoi disa nga revistat e para ne gjuhen shqip “Drita” dhe pastaj “Dituria” (Stamboll 1884 – 1885) ku shkroi nje varg artikujsh. Hartoi librat “Abetare e gjuhes shqipe” (1886), “Shkronjtore e gjuhes shqipe” (gramatika) dhe “Dheshkronje” (Gjeografia 1888). Ai ka shkruar “Shqiperia c’ka qene, c’eshte e c’do te behet” botuar me 1889 ne Bukuresht. Sami Frasheri hartoi dhe nje fjalor te gjuhes shqipe qe mbeti i pabotuar, la gjithashtu ne doreshkrim nje permbledhje kengesh popullore shqiptare. Eshte autor i fjalorit normative te gjuhes turke (Kamus-i turki, 1901) I cili ruan vleren e vet te madhe edhe ne ditet e sotme. Fjalori “Kamus-i turki” permban mbi 40 mije fjale e shprehje gjuhesore. Samiu eshte gjithashtu edhe autor i disa fjaloreve dy-gjuhesh frengjisht-turqisht, turqisht-frengjisht dhe arabisht – turqisht.

Sami Frasheri ka shkruar edhe drama e romane ne gjuhen turke. Vepra me e

rendesishme eshte “Besa”, botuar ne 1875, dhe vene ne skene ne teatrin perandorak ne Stamboll.

Sami Frasheri ka dhene kontributin e tij edhe ne fushen e gazetarisë. Ai ka bashkepunuar me shkrime dhe ka qene redaktor dhe kryeredaktor ne disa gazeta “Sabah” (Mengjesi 1876) dhe “Hafta” (Java).

Ne punen krijuese te tij, zene vend edhe perkthimet, e kryesisht ato nga frengjishtja. Bibloteka e tij personale kishte 20 mije vellime. Sami Frasheri vdiq ne Stamboll ne 1904, duke lene me doreshkrim 11 vepra, kryesisht nga fusha e gjuhesise dhe letersise.

Me poshte jane disa fjale te urta nga Sami Frasheri

- Po te bjere ne det nje pike uje, nuk thahet
 - Mejtimit me te larta gjenden ne fjalet me te shkurtra
 - Ne vend qe te shesesh dituri dhe zotesi, perpiqu t’i fitosh ato
 - Njerezit jane te njejte para natyres, edukata i ben te dallohen
 - Nuk ka gje me te lige se perqeshja, sepse prek te miret me shume se te liqte
 - Njollat qe na ngjiten ne trup, lahen me uje, njollat e shpirtit s’ka gje t’i pastroje
 - Mos shkruaj gje kur je me nerva, sepse, ndersa plaga e gjuhes eshte me e keqe se e shpates, mendo ç’ka mund te jete ajo e pendes
 - Kot perpiqet mendja, kur nuk mund te arrije graden e larte te ndjenjave te zemres
 - Per ndryshimin e dickaje nuk ka asgje me te afte se koha
-
- Goja kalon kufirin, demin e paguan mendja.

- Ai qe pelqen veten e tij, nuk pelqehet nga askush.
- Hipokrizia eshte helmi me i rrezikshem.
- Mos u tremb nga shuplaka e mikut, duhet te kesh frike nga levdata e armikut.
- Peri i ngateruar, nuk zgjidhet duke u ngutur.
- Genjeshtra s'mund ta mund kurre, te verteten. Rrugat e ngushte rrotullohet e rrotullohet e perseri ne rruge te madhe del.
- Zemra eshte nje astrolog qe nuk gabon asnjehere ne zbulimet qe ben.
- Fjala e keqdashesit eshte si qymyri: edhe kur nuk djeg sendin qe e prek, e nxin ate
- Vlera e zjarrit kuptohet ne ditet e dimrit, dhe ajo e bores ne ditet e veres.

fjale te urta

- Nese eshte lumturi te duhesh, eshte lumturi me e madhe te duash.
- Njeriun e bejne te perjetshem veprat e tij.
- Biseda linde nga mendimi, biseda pa mendim nuk eshte bisede, eshte grindje.
- S'ka gje me te keqe se te perqeshurit, sepse me shume prek te miret se te kqinjat.
- Bukuria e njeriut perbehet nga bukuria e fjales qe flet.
- Shpagimi me i embel eshte te besh mire kunder te keqes qe te eshte bere.

- Per te dashurin s'ka gje me te embel, se lotet e syve qe fshihen me doren e se dashures.
 - Arma me e mire per te mposhtur armikun eshte zemra.
-

Sami Frasheri

Hyrje

Sami Frashëri është ideologu më i shquar i lëvizjes sonë kombëtare. Si udhëheqës ideologjik, demokrat, mendje e ndritur prej dijetari, ai mbetet një nga personalitetet më të rëndësishëm të Rilindjes.

Vëllai më i vogël i Abdylit e i Naimit, ai lindi në Frashër më 1850, ku mori edhe mësimet e para. Më 1871 mbaroi gjimnazin "Zosimea" në Janinë, mësoi gjuhë të vjetra e të reja dhe u pajis me një kulturë të gjerë. Më 1872 shkoi në Stamboll për punë dhe atje u lidh menjëherë me patriotë shqiptarë, me Pashko Vasën, Jani Vreton, Ismail Qemalin, Kristoforidhin, Hoxha Tasinin etj. Samiu u dallua shumë shpejt midis tyre dhe, me formimin e shoqërisë së Stambollit, u zgjodh kryetar i saj, ndonëse ishte nga më të rinjtë. Gjer në fund të jetës ai mbeti udhëheqësi kryesor i kësaj shoqërie.

Samiu ishte njeri me horizont të gjerë dhe dha ndihmesë të shquar për kulturën turke. Drejtoi disa gazeta turqisht, ku mbrojti edhe të drejtat e kombit shqiptar. Botoi në turqisht edhe një varg veprash letrare e shkencore. Ndër këto janë disa vepra themelore, si: i pari fjalor i plotë etimologjik i turqishtes, si dhe e para enciklopedi turke e historisë dhe e gjeografisë në gjashtë vëllime. Ai shkroi në turqisht dramën Besa me subjekt shqiptar, bëri përkthime nga letërsia botërore etj.

Veprat e Samiut në turqisht përshkrohen nga ide iluministe dhe godasin obskurantizmin fetar të Perandorisë Osmane. Me to ai i sillte ndihmesë të vlefshme mendimit përparimtar. Duke goditur bazat e pushtetit feudal të sulltanëve ai i ndihmonte njëkohësisht edhe popullit të vet në luftën për liri, edhe popullit turk në luftën për përparim.

Krijimtaria e Samiut në gjuhën shqipe është e lidhur tërësisht me idealet e lëvizjes kombëtare për çlirim, me nevojat e shkollës e të kulturës kombëtare. Pa dyshim ai është një nga themeluesit e saj. Për shkollat e para shqipe Samiu botoi këto vepra: "Abetare e gjuhës shqipe,,(1886), "Shkronjëtoare e gjuhës

shqipe,,(gramatikë e shqipes,1886) dhe "Shkronja,,(gjeografia, 1888). Hartoi edhe një fjalor të gjuhës shqipe, që nuk i dihet fati.

Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e çdo të bëhet

Është një nga veprat madhore të Rilindjes, manifesti politik e ideologjik i saj. U botua në Bukuresht më 1899, në prag të ngjarjeve të mëdha do të çonin në fitoren e pavarësisë. Për këtë, shqiptarët duhet të ishin të përgatitur, të kishin programin e luftës dhe të ndërtimit të shtetit të ri. Duke përgjithësuar përvojën e gjerathershme të lëvizjes kombëtare, kjo vepër e plotësonte më së miri këtë mision.

Siç tregon titulli, vepra përbëhet nga tri pjesë.

Pjesa e parë i kushtohet historisë së kaluar të Shqipërisë. Qëllimi i autorit është të provojë se populli shqiptar është nga popujt më të vjetër të Evropës, me një gjuhë nga më të vjetrat e më të bukurat, me kulturë e tradita të pasura, që ka të drejtë të jetojë i lirë në mes të popujve të tjerë dhe kombeve të qytetëruara. Si shumë rilindës të tjerë, Samiu mbron origjinën pelazgjike të popullit shqiptar.

Një vend me rëndësi i jep në këtë pjesë figurës së Skënderbeut dhe epokës së tij. Skënderbeun e cilëson si një burrë që i ka shokët e rrallë në histori, kurse për epokën e tij shkruan se "është më bukur e më bekuar e gjithë kohërave për vendin tënë,, se atëherë i gjithë kombi ishte i bashkuar dhe u nderua në gjithë botën. Kjo është një nga synimet kryesore të veprës; të forcojë të shqiptarët ndërgjegjjen dhe krenarinë kombëtare.

Pjesa e dytë jep me nota tronditëse një tablo realiste të Shqipërisë pas Tanzimatit. "Qysh janë sot shqiptarët?,-pyet Samiu me shqetësim dhe tregon se gjendja e vendit është e mjeruar nga çdo pikpamje. Burimin e këtij mjerimi ai e sheh në rradhë të parë të zgjedha e huaj, që e ka lënë vendin në varfëri, padituri, dhe errësirë. "Shqiptarët, - shkruan Samiu, - janë robër të poshtuar (poshtëruar) e t'unjurë, të shkelur e të çpërnderë(turpëruar).

Përshkrimi është edhe më i gjallë në kontrast me të kaluarën, të cilën në përgjithësi autori e idealizon. Ndaj dhe stili bëhet më zemërak, vepra e patriotit vlon nga revolta kundër shtypjes kombëtare. Ata shqiptarë të veshur dikur me "roba të arta,, e të farkëtuat me armët e argjendta të trimërisë, shkruan Samiu, "Janë sot lakuriq, me një këmishë që që s'ka ku ta zërë qeni. Vetë edhe zaptieja e taksidari, e ngre shkronjë e i rreh duke thirrur; Pagoni! E

ku të gjejë i ziu që të paguajë? Atëherë shesin kanë, dhinë, ç'të kenë, edhe gjer në qeramidhet e shtëpisë,,.

Vend të rëndësishëm zë analiza që Samiu u bën rreziqeve që i kanoseshin Shqipërisë.

Si gjithë rilindësit, ai mendonte se rreziku i parë Shqipërisë i vinte nga Perandoria Osmane, të cilën Samiu e quante një të vdekur që duhej varrosur sa më parë. Sa më gjatë të mbetej lidhur Shqipëria me këtë perandori të kalbur, aq më keq do të ishte. Shteti osman dotë shembej së shpejti dhe Shqipëria mund të groposej në gërmadhat e tij. Rreziku tjetër, mendon Samiu, shqiptarëve u vinte prej lakmive të shovinistëve fqinjë, lakmi që i mbështetnin fuqitë imperialiste.

Rreziqe të mëdha shqiptarëve edhe prej grindjeve e përçarjeve midis tyre, sidomos prej përçarjes fetare, gjithashtu prej padijes, prej mungesës së shkollave shqipe. Këto rrethana i hapnin shteg rrezikut të asimilimit të shqiptarëve prej të huajve.

Pjesa e tretë, fillon me pyetjen: "A mund të qëndrojë Shqipëria si është? Përgjigjja është, jo,,. Në përgjithësi në këtë pjesë Samiu paraqet programin e lëvizjes për të ardhmen e Shqipërisë.

Nga analiza që u bëri rrethanave politike në fund të shekullit XIX, Samiu arriti në përfundimin se rruga e vetme për të shpëtuar nga zgjedha osmane dhe nga rreziku i copëtimit prej shteteve fqinje ishte që Shqipëria të shkëputej nga Turqia menjëherë, para se ajo të shembej dhe shqiptarët të formonin shtetin e tyre të pavarur. Autori mendonte se kjo s'arrihej me lutje, por me rrugën e luftës së armatosur. "Shqiptarët duhet t'i marrin ato që duan me pahir, t'i kërkojnë me fjalë, po të kenë edhe pushkën plot,,.

Si mendimtar demokrat dhe iluminist, Samiu parashtron një projekt të gjerë me ide të përparuara për të ardhmen e Shqipërisë. Ai nuk e pranon idenë e monarkisë. Si formë regjimi sipas tij, Shqipëria duhet të ishte republikë parlamentare që do të kishte në krye një pleqësi. Kushtetuta e shtetit të ardhshëm shqiptar që propozonte Samiu, përshkrohet nga fryma demokratike. Ideali i tij për këtë shtet ishte ideali i një demokracie borgjeze. Si shprehës i pikëpamjevetë klasës së re të borgjezisë, ky ishte një ideal i përparuar për kohën, sepse ai i kundërvihej shtetit despotik osman.

Shumë i guximshëm e i përparuar për kohën ishte projekti i Samiut edhe për zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit. Ai kërkonte të ngrihej një industri kombëtare, të mëkëmbej bujqësia, të zhvillohej komunikacioni automobilistik dhe hekurudhor, të forcohej mbrojtja etj. Vëmendje të veçantë Samiu i kushtonte zhvillimit të arsimit e të kulturës shqiptare. Si gjithë rilindësit, ai kishte bindjen se ajo që u duhej më shumë shqiptarëve ishte dituria. Për

përhapjen e saj ai kërkonte një sistem arsimit të përgjithshëm e të detyrueshëm për të gjithë, djem e vajza. Arsimin e donte në gjuhën amtare shqipe dhe shkolla të ishte laike, e shkëputur nga kisha e xhamia, një shkollë që të shërbente si vatër diturie dhe atdhetarizimi.

Samiu ëndërronte Shqipërinë me shkolla të të gjitha kategorive, me universitet ("gjithëmësime,, siç e quante ai), me akademi të shkencave, muzeume e biblioteka.

Siç shihet, në veprën "Shqipëria ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhet,, gjeti shprehje mendimi shqiptar më i përparuar politiko-shoqëror i kohës. Me këtë vepër Samiu u bë ideologu më i shquar i lëvizjes kombëtare shqiptare. Vepra e tij është një traktat politiko-shoqëror, megjithatë ajo ka vlera të mëdha stilistike, një gjuhë e gjallë, e shprehëse. Stili i prozës së Samiut është energjik, herë polemist, herë fshikullues e herë me patos thirrës e mobilizues. "O burrani o shqiptarë ! Zihuni me të dy duart në besë, në lidhje e në bashkim, se kjo do t'ju shpëtojë!,,

Fraza e Samiut është e qartë, me mjete gjuhësore plot ngarkesë emocionale. Mbasi ka parashtruar krejt programin e tij, ja si e mbyll veprën; "Ja qëllimi ynë! Ja puna jonë e shenjtëruarë! Ja besa jonë! Në mes të shqiptarëve të vërtetë s'ka ndonjë ndarje, ndonjë çarje, ndonjë ndryshim! Janë të tërë vëllezër, të gjithë një trup, një mendje, një qëllim një besë!,,

Kjo vepër solli një ndihmesë të madhe për pasurimin e gjuhës letrare shqipe dhe për formimin e stilit publicistik.

Samiu vdiq në Stamboll më 1904, i përndjekur nga autoritetet dhe i respektuar nga populli dhe opinioni përparimtar.

-Njeriu duhet të përpiket të mësojë çdo gjë, jo të tregojë veten e tij.

-Më i forti i njerëzve është ai që është i Zoti të përmbajë vetveten.

-Shpata e grave është gjuha e tyre, prandaj nuk e lënë të ndryshket.

-Zbavitja më e bukur për njerinë është leximi, shoku më i mirë libri.

-Personi që do ti, s'ka asnjë të metë, fillo të mos e duash, pa shih sa të meta ka.

-Thjeshtësia e një gruaje është më e vlefshme se stolitë (diamantet) e të gjitha grave të botës.

-Kush lexon shumë, medeomos bëhet i mençur ; kush punon shumë, medeomos bëhet i pasur ; kush kujdeset për higjienën, medeomos bëhet i lumtur. Ai që i plotëson të gjitha këto kondita, le të thotë se ka bërë me të vërtetë jetë në botë.

-Njeriu i pajisur me edukatë dhe me moral të mirë, në çdo gjendje që të ndodhet, prapseprapë njeri është.

-Mësimi më i madh në këtë botë është vështërsia ; s'ka sukses ai që nuk has në vështërsi

-Njeriu i përsosur është ai i cili çka bën në sy të botës mund të bëjë në vetmi dhe çka bën në vetmi mund të bëjë në sy të botës.

Fjale e urte!

*** Mos i poshteroni njerezit e medhenj per nje a dy fjale te tyre, sespe diamanti, sado i prere shtrember te jete, eshte me i vlefshem se nje gur i zakonshem, i prere ne formen me te persosur**

Sami Frasheri

Shqiptarëtë gjithnjë për botën, e kurrë për vetëhe

Sami FRASHERI

Shqiptarëtë gjithmonë janë vrar' e përpjekurë e kanë cpërkaturë të tërë faqen' e dheut me gjakt të tyre; po nga gjaku i Shqipëtarëvet të tjerë kanë fituarë, Shqipëria s'ka parë nonjë të mirë. Shumë shqiptarë janë çquarë e kanë treguarë vetëhenë në dituri e në të tjerë gjërëra; po me këta të tjerë mburenë e jo Shqipëtarët' e Shqipëria.

Me Pyrron' e me Aleksandrinë mburenë Grekëritë e i quajnë Grekër, Maqedonasitë, që me trimërit e tyre muarrë gjithë botënë në pakë kohë nuk i suallë nonjë të mirë Shqipërisë, po Grekëritë, që 'ishinë armikët' e tyre, u ranë pas e i rrethuan, edhe këta fituanë nga gjaku që derdhë ata. Se Maqedonasitë

përndanë nëpër gjithë vendet, që muarrë, gjuhën e qytetërin' e Grekët e jo të tyren; q'ish shqipja. E shumë e botës edhe sot Maqedonasitë i zënë për Grekër. Vërtet, të mos ishin Maqedonasitë gjuha e Greqet e qytëri' e tyre do të mos kish marrë dot kurrë këtë bujë, që ka sot, edhe mbase do të kish humbur' e t'ish harruarë fare; se shkoll' e Aleksandrisë edhe të diguritë që arrinë n'Egjiptë në kohët të Ptolemenjet, e bënë gjuhën e qytetërin' e Greqet të përndahetë e të dëgjohetë me gjith' anët të dheut. Ptolemenjtë, q'ishin fjeshtë Shqipëtarët nga Çamëria e gjithë Maqedonasitë lanë gjuhën' e tyre, shqipenë, me një anë të haruarë e të paditurë e vunë përpara greqishten, gjuhën' e Dhimosthenit, që ka folurë aqë kundër Maqedonaset.

Pas grekëvev erdhë Romanëtë; edhe këta fituan shumë nga Shqipëtarëtë: trimëri' e Shqipëtarëvev e mendj'e tyre shërbente mburjen' e Romanëvev e jo të tyren. Shumë njerës trima e të diturë kan' arriturë edhe në kohët të këtyre në mest të Shqipëtarëvev, po bota i ka njohur si Romanë e jo si Shqipëtarë.

Pas Romanëvev u erdh radha Tyrqet. Shqiptarëtë duke përzjerë me Tyrqitë, kanë marrë anë në gjithë luftërat, që bëninë e që fitonin këta kundër gjithë botës; edhe më të madhe në trimëri e më të miratë punëra i bëninë Shqipëtarëtë, po emëninë e kishinë Tyrqitë, edhe gjithë bota i dinte Tyrq e njeri s'njihte si Shqipëtarë. Më të mbëdhenjt' e më të mirët' e Vezirëvev të Tyrqisë ishin Shqipëtarë, si Sinan-Pasha që ka marrë Jemenë e ka shpënë fjamurin' e Tyrqisë gjer në detet t'Indisë, si Qyprilinjtë q'e kanë shpëtuarë mbretërin' e Tyrqisë nga një rezik të math e e forcuan aqë këtë mbretëri, sa van' e rrethuan Vjenënë. Edhe shumë të tjerë njerës të mbëdhenj e burra tirma kan' ardhurë, prej të cilëve Tyrqia ka fituarë shumë, po Shqipëria aspakë. Në kohërat e pastajme Shqipëtarëtë myslimanë kanë punuarë e janë vrarë për Tyrqitë e Shqipëtarëtë e krishtenë për Grektë, për këta dy kombe të cilëtë as njëri as t'jatri s'ua dinë të mirënë e ja u çpërblejnë me të keqe duke përpjekurë për humbjen' e kombit shqiptar. Boçari, Xhjavella, Miauli e të tjerë më të shumë' e trimave, që janë përpjekurë për ngjalljen' e për dlinin' e Greqisë, kanë qenë fjeshtë Shqipëtarë e jo fare Grek; po nga trimëri' e tyre ka fituarë shumë Greqia e jo fare Shqipëria. Në syt e botës lëftoninë Greqtë e Tyrqitë, po në të vërtetët luftonin Shqiptarët' e krishtenë me Shqiptarëtë myslimanë. Kur muntnin' ata, fitonte Greqia; kur muntninë këta, fitonte Tyrqia; po gjaku që derdhesh nga të dy anëtë, ish gjak Shqipëtari. Shqipëtarëtë vritenë vëlla me vëlla, të tjerë fitojnë...Shqipëtari e ka derdhurë gjithnjë gjaknë pa kursim, po e ka derdhurë kot; kurrë Shqipëria s'ka fituarë nga gjaku i Shqipëtarëvev: gjithnjë të huaj edhe armikë të Shqipërisë kanë fituarë nga ay gjak i vjejturë e i derdhurë pa mendim!

Jo vetëm me kordhë e me gjak,po edhe me pëndë e me mënt Shqipëtarëtë kanë shërbëtuarë gjithënjë të huajtë. Me të mos shkruarë gjuhën' e tyre janë

shtrenguarë të shkruajnë greqisht, llatinisht, shqahisht, tyrqisht a arabisht; edhe me emënit të tyre mburenë të zott e këtyre gjuhëve e Shqipëtarët pandehenë t'egër' e të paditurë, gjith' i qeshinë duke thënë se ja u ka ngrënë buallica livrën' e tyre. Po Aristoteli, m'i madh i filosofëve të Greqisë së vjetërë, ishte maqedonas, do-me-thënë Shqiptar e jo grek. Vërtet në Stagjyrë, tek kalindurë ishin edhe ca Greq t'ardhurë, po fytyr' e Aristotelit, që shohim n'agalmët të ti edhe gjuha greqisht, q'e ka shkruarë të përtuarë e jo aqë të drejtë si dhe miqësia, që kish me Filipnë, anëmikn' e Greqet, e të tjera shenja tregojnë se ky filozof i math nuk ish lindurë prej nonjëj nga Greqia, që kishin ardhur në Stagjyrë, po prej një stagjyraku vëndës e ish maqedonas, do-me-thënë Shqipëtar i thjeshtë.

Në kohët të Tyrqet kan' ardhurë shumë Shqipëtarët të diturë, që kanë shkruar livra e vjersha turqisht a arabisht. Vetëm vjershëtarët shqipëtarë, që kanë shkruarë vjersha turqisht janë aqë të shumtë sa emënat e tyre mundt të mbushinë një livrë të tërë. Jahja-Beu, q'është një nga më të mbëdhenjt' e nga më të dëgjuarët e vjershëtarëvet tyrq, është shqiptar.

Shqipëtarët e kanë tregua gjithë jetënë që janë të zottë edhe me kordhë edhe me pëndë, edhe me trimëri, edhe me mënt e me dituri, e Shqipëria ka nxjerrë shumë njerës të çquar' e me nam të math, po nonjë nga ta s'ka punuarë për Shqipërit' e cila ka mbeturë gjithënjë e varfërë e e padëgjuarë, e me djemt' e saj mburenë të tjerë vende e të tjerë kombe.

Është ndodhurë një shqiptar i zoti të ngjallnjë Ejgyptënë e të bënëj prej këti vendi të humbur' e të prishurë, si ish atëherë, një vënt të pasur e të ndrituarë, si është sot. Një Mehmet-Ali, shqisipëtar i pamësuarë u ndoth i zoti të shpëtonjë kështu një vënt të huaj e të largë, po kurrë një shqipëtar s'është ndodhurë t'i bënëj Shqipërisë një të mirë të këtillë.

P'andaj duke mbaruarë këtë fjalë, themi prapë me hidhërim zëmre që: Shqipëtarët kanë punuarë gjithëmonë për botënë e jo kurrë për vetëhe. Vetëm një Skënderbe ka punuarë, në kohërat e shkuara për Shqipërinë e vetëm ay është me të vërtetë mburje për Shqipërinë.

Botuar më 1899

Qysh janë sot shqiptarët?

Sami FRASHËRI,

Thamë më siprë që shqiptarëtë, duke rënë në duart të tyrqet, nukë hynë në kurth si e pandehninë, e nuk'u bënë ropt' e tyrqet, po shokët' e tyre, me të cilët bashkë hidheshin mi kombet e tjerë, rripnin e rrëmbeninë edhe ktheheshinë në vent të tyre ngarkuarë me gjë. Edhe Shqipëria ish e dlire e pothua me vetëhe. Kaqë qint vjet shqipëtarëtë rojtnë kështu. Po kështu rojn edhe sot? Jo, Kurrë! Sot shqiptarëtë janë robër, të poshtuar, e t'unjurë, të shkelur' e të çpërndarë shumë më teprë se të tjerë kombe të Tyrqisë që janë më të poshturë nga greqtë, nga shqetë, nga armenëtë edhe nga judhenjtë!

Tyrqia e ka ngriturë besënë nga shqipëtarëtë, nuk i beson e i vështron si anëmikë e si trathtorë, jo si shokë e si vëllezrë, si i vështronte qëmoti. Sot shqiptarëtë e mer ushtar, e mundon e e reh që të mësonjë gjuhën e ti, kërkon t'i mësonjë diturin' e luftësë, të cilënë ay vetë s'e di e të cilënë shqiptari e ka mësuarë duke thëthiturë qumbështit e s'ëmësë. Nuk' e mëson të gjorinë, po e mahit e e çpërmënt, e mer për tre vjet, e mban dhjetë vjet nën' armë lark shtëpis e lark mëmëdheut të ti, edhe qysh? Lakuriq, t'urëtë, të sëmure, të varfërë! Në luftë e vë të vritetë kot; urdhëronjës i ti, q'është tyrk, i paditur' e i frikçimë, e fut në një **** nga s'deletë. I gjori shqipëtar, me gjithë këto, Lëfton lakuriq, e i urëtë e me armë të meta, Lëfton si dragua, e tregon trimërin'e ti e nderon tyrqit' e Tyrqinë. Po a i dihetë, a çpërblehetë për gjakt, që derth! Jo, kurrë! Ushtari shqipëtar, në mos vdektë në luftë, vdes nga sëmundjeja, nga të pangrënët e nga të pamveshurit. Nga ata që venë n'ushtëri fort të pake kthehenë në shtëpi të tyre. E urdhëronjës kush bëhetë? Gjithnjë tyrqitë; gjysmës' e ushtrisë së Tyrqisë janë shqipëtarë, po as një i njëqintë i urdhëronjëset në Tyrqiu s'është shqipëtar.

Shqipëtarëtë, q'ishinë mësuarë të mos paguajnë gjë, tani janë futurë nën' aqë të rënda pagesa, sa s'mundinë të ngrenë krye. Tyrqitë, që janë zotërinjt, e tyre që pesëqint vjet e tëhu, s'u kanë mësuarë shqipëtarëvet, as punë, as mjeshtëri as dituri, po i kanë mësuarë të lëftonj; e të rrëmbejnë, tani përnjehre duanë t'u marrënë armëtë e u thonë: paguani! E ku të gjejnë të gjorëtë që të paguajnë? S'kanë të hanë vetë. Ata shqipëtarë, që pakë kohë më parë ishin të mveshurë me rroba t'arta e të farkuarë me armë t'ergjenta e të lara, ata a të bijt e tyre janë sot lakuriq me një këmishë, që s'ka ku ta zërë qeni! Vete edhe zaptijeja e tahsildari, e ngre shkopt' e i rreh duke thirurë: pagoni! E ku të gjenj' i ziu që të paguanjë? Atëherë i shesinë kanë, dhinë, ç'të ketë edhe gjer në qiramidhet të shtëpisë! Shqipëtari të hajë dru për të paguarë! O ç'turp i math! O ç'e madhe e keqe! Mos e durofsh, O Perëndi!

Kështu është sot gjithë Toskëria edhe shumë vende të Gegërisë. Ca vende të Gegërisë, që kanë mbajturë armëtë e kanë qëndruarë në malet të tyre të rreptë, nukë janë shkelurë kaqë; nuk apënë ushtarë e s'paguajnë pagesa; po

edhe këta rojnë si t'egërë pa nonjë qeveri, duke vrarë përditë në mest të tyre. Edhe këta po i ha varfërija, se s'kanë nonjë fitim edhe vendet e tyre janë të rjepur' e të varfërë. Me gjithë këto, edhe qeveri' e tyrkut ditë më ditë po i rrethon më s'afëri; rahënë t'u marinë armëtë, që t'i bëjnë edhe ata robër të poshtërë e të dobëtë e t'u ncjerrënë edhe lëkurënë!

Shqipëria që gjer dije qeverisësh e urdhërohesh prej shqipëtarësh, si e thamë më siprë, sot urdhërohet' e qeverisetë prej tyrqish të huaj e prej njerës të poshtër' e të pandërçim, të cilëtë i blenë vëndetë në Konstantinopojë me të holla e vinë të rjepinë Shqipërin' e shqipëtarët, për të nxjerrë ato të holla që kanë dhënë edhe aqë të tjera që do të vjedhinë për vetëhe të tyre!

Shqipëria, sado q'është' e varfër' e e paditurë, ka njerës të zottë për të qeverisurë vendin e tyre, si e kanë qeverisurë kaqë kohë me nder e me të drejtë. Po këtyre shqiptarëve le që s'u epetë punë në Shqipëri, po as i lenë të shkelinë në mëmëdhet të tyre të dashurë! U apënë nga një copë bukë për të zënë gojënë e i mbajnë si sklef nëpër më të largët çipa t'Anadollit e t'Arabistanit! Veç nonjë trathëtor ku të gjendetë, ay është për nder!

Botuar në vitin 1899

Punërat' e Përgjithçime

Sami FRASHERI,

Pas diturisë kujdes' e shqipëtarëve e m'e madhe nevoj' e tyre do të jete për punërat' të pergjithçime, të cilatë do të sjellinë begati e pasje të madhe në Shqipëri. Udhëtë, udhët' e hekurta, limanetë, të hapurit' e lumenjet e kënetave, metaletë, pyjetë etj, janë më të nevojshimet' e më të vyerat' e punëravet, që do të bënë Shqipëria, me të pasurë duart' e këmbëtë xgjidhurë. Udhëtë, për të cilat tani shqipëtarëtë paguajn' aqë sa muntte me to të farkohëshinë gjithë udhët' e Shqipërisë me ergjënt, munt të goditenë më fort me pakë ergjent prej një qeverije së drejtë e me nder e të punojnë njerëzit e kafshëtë pa rezik me të gjith' anëtë.

Një udh' e hekurte të nisetë prej Manastiri e, si të shkonjë nga Korça, të ndahetë me dy dega, nga të cilatë njëra të sositë në Prevezë duke shkuarë nëper Janinë, e tjetra të shkonjë në Berat e në Skenderbegas edhe s'andejmi të ndahetë prapë më dy për të sosurë njëra në Vlorë, tjetra në Durrës, duke xgjaturë edhe një degë gjer n'Elbasan. Një tjetër udhë nga Manastiri të shkonjë n'Ohri e s'andejmi, duke marrë anën e Drinit, një degë t'unjetë në Shkodrë e në Lesh; tjetra të shkonjë nga Prizreni e të bashkohetë në Ferizovik me udhët te madhe, që vet në Selanik e n'Avstri.

Këto urdhëra të hekurta edhe me ca degë të dyta mundane të mbarohenë pak kohë ndo prej shoqërije të huaj ndo prej Shqipërisë vetë me të marrë pakë hua e të sjellinë në vëndit një pasje e një qytetëri të madhe.

Pas udhëvet m'e para punë për të bërë, është Myzeqeja. Kjo fush' e gjerë është një magj' e madhe, që munt t'ushqenjë gjithë Shqipërinë e të nxjerr' edhe shumë drithë e të tjera gjerëra, po që të ndërtohetë si duhetë. Për të ndërtuarë kjo fushë, duhetë të hapenë lumenjtë, Semani, Lum' i Beratit, Devolli etj, si edhe Vjosa e Shkumbini, që rrjedhinë nëpër anët të saj. Këta lumenj duhetë të thellohenë e t'u bëhenë mure, tek duhetë, që të mos përndahetë ujët e tyre nëpër fushët. Atëherë munt t'u bëhenë edhe ca dyerë e vija që të hapen' e të mbyllenë e me të cilatë të ujitetë gjithë fusha. Atëherë do të mundane të përthahenë edhe kaqë kënetë e moçale, në të cilat qëndron ujët' e teprë në verë e prish edhe erën' e gjithë vendit duke qelburë; edhe në dimërë do të shpëtonjë gjith' ajo fushë nga të qenetë një kënet' e paprerë e mbyturë n'ujë. Myzeqeja do të bëhetë një ar' e gjer' e e gjatë e cila, me qenë nën'ujë e me të pasurë një dhe fort pallor, do të bëhetë një Egjypt' e dytë. Bregoret' e Mvzeqesë munt të mbulohenë me vreshta e me ullinj; edhe luadhër' e saj munt t'ushqejnë kuaj e bagëti, sa të mbushinë jo vetëm Shqipërinë po edhe Evropënë.

Të hapurit' e limanit të Durrësit, liman i gjer' e i bukurë n'anët të veriut të këtij qyteti, të cilënë Sulltan Mehmeti e ka mbyllurë me padituri të ti për të mos hyrë aniet' e veneçanëvet, të hapurit' e grykës së këtij limani edhe të thelluarët' e të brëndësmit do ta bënë këtë qytet të përsëritetë si ka qenë një herë qëmoti e të bëhetë një Trijest' e dytë a një tjetër Selanik. Edhe shumë të tjerë limane munt të hapen' e të qërohenë nëpër anët t'Adriatikut, si Butrintoja etj, e shume skela me tregëti të madhe të çpikene e të venë mbarë.

Një shoqëri vaporesh munt të ngrihetë e të punonjë vapore nëpër skelat të Shqipërisë edhe gjer në Trijeste, në skelat t'Italisë e të Greqisë. Vapore e anie mund të punojnë edhe nëpër kënetë të Shkodrësë, t'Ohrisë, të Prespësë etj, si edhe në ca nga lumenjtë, që do të hapenë.

Gjithë këto punëra si edhe pyjet' e metaletë do të vështohenë prej ministrës së punëravet të përgjithçime. Çdo pyll do të ndahetë me disa ngastra edhe, gjer sa të vinjë radha të pritëtë gastr' e funditë, gastra q'u pre të parenë herë, do të jet' e arritur për sërish; e kështu gjithnjë do të pritete lëndë nga pyjet edhe kurrë pyjetë do të mos mbarohenë, po do të përsëriten' e të jenë kurdo të lulëzuarë. Metaletë do të kërkohenë nëpër të gjith' anët të Shqipërisë e të nxirenë kudo të gjendenë.

Edhe mjeshtërite e tregëtija si edhe bujqësija e bagëtija do të kenë kujdesën' e kësaj minister, e cila do të përkujdesetë të vejë mbarë, në çdo vent ajo mjeshtëri, në të cilët jane mësuarë vendësitë; leshi, liri, pambuku, mëndafshi,

hekuri, druri t'arrihet' e të punohetë sa të mundetë me tepërë, që të mos ketë Shqipëria aqë shumë nevojë të sjellë nga këto së jashtësmi.

Botuar më 1899

Qytetëri e grekëve

Sami FRASHERI.

Thamë në Fletoret që shkoj ç'është qytetaria, ku është çpikurë më parë edhe qysh ka qenë qytetëri e kombeve të vjetërë t'Asis'e t'Afrikësë. Në atë fjalë kishim taksurë' të bëjmë fjalë veçan edhe për të tri qytetërit' e pastajme, domethënë për qyteërit të Grekret të Arapëvet edhe të Evropianëvet. Të zëmë nga qytetëri e Grekret që është m'e vjetra, po thua aqë e vjetërë sa qytetërit'e moçime që zumë ngoje në Fletoret tjetërë.

Qytetëri e Grekret nuk ngjan me qytetërit' e Babilonaset e të Asyrjanëvet a të Egjypjanëvet, të cilat ishinë si një foshnj' e shtënë nga barku i s'ëmës pa arriturë, po ish një qytetëri e vërtetë me gjithë degat të diturisë. Këtë qytetëri nuk' e dimë nëpër erë e nëpër mjergullë si ato të tjerat, po e kemi të gjallë, në mos në punë, nëpër kartëra të shkruara prej njerës të asaj kohe. Kjo qytetëri është far' e qytetëris'së Arapëvet, në kohra të mesme edhe e asaj s'Evropjanëvet të-sotmë.

Nukë dotë heqimë mundim të madh për të treguarë ku ndodhet vend' i këtij kombi që u ndritua që kaq moti me kaq dituri edhe qe mëndj'e-tyre çkëlqen edhe sot e këtë ditë brenda në qyteëri të kombeve t'Evropësë. Këtë vent, Grekërinë e kemi aq afërë sa s'ka njeri të mos e dijë. Për të marë vesh qysh është çpikur'e qysh ka vajturë mbrodh qytetaria në Grekëri, duhet të hedhim një herë sytë n'istorit t-saj e ta zëmë që nga krej.

Në një kohë shumë të vjetërë, të cilënë historia s'apin dot ta zërë fill e-tërë Grekëria ishte vend'i stërgjyshëvet tanë, i Ilirëvet a të Lirëvet, si thuheshin atëherë Shqipëtarëtë. Më pastaj erdh një komp tjetërë prej Asije në Grekëri edhe ca nga njerëzit'që gjeti atje i përhapit duke përzjerë me të tjerëtë e duke bërë Grekretë. Po me të qenë që stërgjysre të tanë ishin më të qytetuarë, ky komb'i ri mori besënë e atyre edhe gjuh'e tyre u bë e përzierë prej të dy gjuhëvet. Vendi që u mbet këtyre ish shumë i-mirë për të qytetuarë, se u ndoth i-rethuarë me det me shumë pellgje për anija e me të qënë përtej vendeve të-qytetuarë'e të pasurë, si Asi'e-Vogël, si Syria e Finiqi, si Egjypta

etj.

Vërtet pas hkuantë shumë kohë, Grekretë zunë të njiheshin me kombet e Azisë, edhe ngjan që të ken'ardhurë shumë botë prej Finiqi e prej Egjypte e të jenë përzjerë me Grekretë, se në gjuhët greqisht gjendenë shumë fjalë të gjuhëveve simite, të cilat as në gjuhët tëna që është mëm'e saj as në gjuhërat të-tjera të fëmijësë arjane nukë dukenë. Si do të jetë puna, Grekretë fituan shumë nga të përzjerët' e nga të bërë tregti me kombet e-përtej-detshime. Gjer sa që erth një fenikas, që e quanin Kadhmo, as Grekrët as të-tjerëtë kombe t'Evropësë nuk dininë se ç'dotë thotë shkruarj' e këndim; Kadhmu, i-cili duket se nuk erth vetëmë po me shumë shokë si thamë më sipërrë, u mësoj Grekërvet shkronjat'e vendit të ti me të cilat edhe këta zun' e shkruanin gjuhën'e tyre. Kjo është jurma e parë që bënë n'udhë të qytetërisë. Në ato kohëra edhe të tjerë njerës prej Asije a që kishin qënë n'Asi, si Orfeu nga Thraqi e si Foroneu nga Egjypta suallë nga Grekëri ca dituri e ca mësimë, të-cilatë këta pas zakonis t'asaj kohe i përzjenë me besëtë. Një tjetërë asias që thuhesh Mino u hodh në Kretë, e s'andejmi u tregoj Grekrët gjyqn' e qeverinë e vëndit. Disa qinde vjet Grekret'u muarë me këtë dituri, duke shpënë ato sa mbar'e më mbarë, duke ndërtuarë gjuhën'e tyre e duke nxjerrë vjershetarë si Omir'e si Isodhnë (Esiodi-A.K). Po kurrë nukë thanë se mjaft dimë, edhe me të diturë që n'Asi e n'Egjyptë ish dituria e qytetaria m'e tepërë, gjithë t'urtët'e-tyre, përpara se të bëjn'a të shkruajnë gjë, vinin një herë rotullë Asis'së Vogël, Syrisë e Egjyptësë.

Solloni që vuri n'Athinë një nom fort të mirë, me të cilënë i vu themel gjithurdhërisë (dhimokratisë), e bëri Athinënë të quhet kërthiz' e Grekërisë edhe ms'i gjithë botës së qytetëruar t'asaj kohe, qe rotulluarë nëpër Asi e pat par'edhe Egjyptënë.

Të-parët'e të urtëvet Grekre nukë kanë dalë brenda në Grekëri, po në mes të Grekrëvet që gjendeshin nëpër anët të detit t'Asis'së Vogëlë e nëpër nisit që janë përkunduell atyre anëvet. Se ata kishin më tepërë të bëninë me kombet'e-qytetuarë t'Asisë. Kështu Thaliu m'i par'i të urtëvet Grekre që nga Asi e-Vogëlë edhe atje e ngriti shkollën' e ti, pastaj mësonjësit'e ti u-përhapnë nëpër Grekëri e gjithë ku ndodheshin Grekre.

Gjer në kohët e Thaliut gjithë dituritë, që kishin sjellë prej Asije a që kishinë çpikurë Grekretë, ishinë të përzjera me besët e tyre. Këto dituri vetëmë mëndj'e të holluar'e të urtëvet mundte t'i çpleksnjë e t'i qëronjë nëpër mes të përrallave të besës s'asaj kohe. Po sot kupëtohetë fort kthillëtë që ato përrallat'e asaj bese, që bot' e poshtërmë u besonte e u falesh pa kuptuar, kishin rënjënë në një urtësi të lartë t'ardhurë prej Persije, prej Hindi e prej Egjypte.

I-pari Thaliu e çqeu cipën e besësë që mbulonte urtësinë edhe tregoj urtësinë

lakuriq e të bukurë si është. Veç q'ë ndau urtësinë nga bes'e atëhershime po edhe e tregoj fare të-ndryshme nga ajo besë. Kjo urtësi kish për rënjë besimnë me një shpirt të përgjithçime, me një fuqi të pa-ançime me një fjalë, me një Perëndi e nukë më shumë, si besonin' atëhere Grekrëtë. Që edhe kjo rëfen që ajo urtësi që e-ardhurë prej Asije, e e çkukurë që nga rez'e maleve Malajë, tek besohesh që herësh një Perëndi. Nga mësonjësit'e Faliut Anaksagora është m'i ndjeshmi që ka ndihurë shumë për të shpënë diturin'e mjeshtërit e ti më përpara e për të ndarë atë nëpër botë.

Më pas doli Pitagora, i cili veç që e çqojti më tepërë diturinë e pa-lënttë, po cepiku edhe shumë të vërteta për dhemasënë edhe i vuri themel kësaj diturije e-cila është dor' e djath' e qytetërisë. Mësonjësit' e Pitagorësë qenë të shumë edhe u përhapnë nëpër gjith'anët. Sado që Grekrët' e atëhershimë për të mbuluarë brsën e-tyre nga dijat e-ra të këtyre të cilat'i shihninë kundra besësë, i ndoqnë e i përzunë duke vrar' e duke therurë ata q'u binin në dorë, po shumë prej syresh shpëtuanë, edhe diturit'e tyre jan'edhe sot të gjalla. Të marëtë sado të vrasin' e të therinë, i ndoqnë e i përzunë duke vrar'e duke therurë ata q'u binin në dorë, po shumë prej syresh shpëtuanë, edhe diturit'e tyre jan'edhe sot të gjalla.

Të marëtë sado të vrasin e të therinë t'urtëtë, kurë të dituritë s'mundënë prej të paditurët, edhe kurë egërsia e përallatë s'qendrojnë dot kundruall dituris'e urtësisë. P'andaj, me gjithë këto shtrëngime që tregonte besa, urtësia nuk po mbytesh po sa vinte po shtohesh e me të gjith'anëtë po çfaqeshinë njerës t'urtë që çpikninë gjërra të pa-ditura gjer m'atëherë.

Gjer më një kohë duket urtësi e grekrëvet e marë prej Asij, pastaj t'urtët'e këti vendi çpiqninë gjërra që Asia e Egjyta s'ngjan t'i ketë diturë kurë.

Hipokrati në nisit ku vuri themel shërimit, të tjerë t'urtë shkruanë si cili do për një degë të diturisë. Shkronjësit e vjerëshëtorëtë në këto kohëra patnë ariturë shumë lartë. Liri e qeveris' së tyre u epte dorë të flisnin çpenguarë, me këtë ndihmë kishin dalë shumë gjuhë-bukurë e shumë shkronjës të vërtetë të cilëvet shkronjat u këndohen edhe sot e kësaj dite me çudi si Herodoti, si Tuqididi, si Dhemosdheni, etj. Me nj'anë tjetërë bes'e tyre që s'para kihesh me sy t'urtëvet, ish shumë e përdorshme për vjershëtorëtë edhe më tepërë për ata që shkruanin vjersha për theatre. Edhe theatr'e tyre që kish vajturë shumë mbarë edhe histori e-tyre që përzjente njerës e perëndirra, edhe trimëri e-tyre e zakonet i kanë bërë vjershëtorët' e-tyre që janë edhe sot pa shokë, si Omiri, si Euripidi, si Sofokliu, etj.

Sokrati është i dyti pas Pitagorës që përhapi diturinë në Grekëri. Sado që ky vetë nuk shkroj me dorë të ti, po fjalët'e ti ndezë mëndjet e mësonjëset të ti, edhe urtësi e-ti duketë në shkronjat të Platonit e të Aristotelit. Këta të dy të urtë të mëdhenj e ngritnë fort lart diturinë, duke shkruarë veçan për cilëndo

nga degët e saj. Shkronjat e këtyre më tepërë se një mijë vjet kanë qënë drit' e gjithë kombeve të qytetuarë pas të cilave kanë vajturë mijëra të urtë, edhe sot e kësaj dite s'janë të-pëlqyera. Po dituri e këtyre nuk para u vjejt grekrëvet, se goditi afër fundit të qytetëris' së tyre, e cila nënë urdhrit të Aleksandrit të Madh e të trashëgonjëset ti, me gjithë që aty që përkujdesës e mburonjës e përhapës i diturisë, u veshk, edhe pataj nën urdhrit të Romanëvet erdhi në vendit të saj, edhe sot ron me Itoritë e në të tjera shkronja të pavdekura të tyre. Koha që ndriti më tepërë qyteëri e Grekrëvet, aqë në dituri sa edhe në mejshtëri, qe koh'e Perikliut, do-me-thënë koha në të cilënë krye i gjithëurdhërisë s' Athinës ishte Perikliu. Atëherë Athina ish Paris i asaj kohe me gjithë bukuritë që mundte të bënte dor'e njeriut. Mejshtëri e kthisërisë ish tëholluarë fort edhe të gdhendurit e gurit e të bërët e agalmavet kish ariturë në një shkallë që sot Evropjanëntë, me gjithë atë qytetëri, s' mundinë ta arrijnë. Qytetëri e Grekrëvet u çfanit prej Grekërije, po nukë humbi, e shkornjat'e tyre ndodhenë të shumat si edhe shumë nga punërat e mjeshtëris' së tyre, edhe histori e-tyre është' aq' e diturë, sa me të mbyllurë sytë i shohëmë të gjallë. Qytetëri e Grekëvet të-vjetërë s'u shua, po flejti shumë kohë nënë një hije të dëndurë t'egërsis' e të paditjesë, gjer sa e gjetn' e e ndezë përpara Arapëtë edhe më pastaj Evropjanëtë, si do ta shohëmë.

Botuar më 1884

Qytetëri e evropianëvet

SAMI FRASHERI,

Qytetëritë që treguamë gjer tani, duke vënë radhazi me qytetërin' e Evropjanëvet, janë si foshnja të dështuara kundreq njerëzve t' ariturë; po, me të qënë në ç' do gjë q' është m'e par' e m'e vjetërë është' edhe m'e rënd' e m'e vjejturë' si e çpikurë prej mos qenje, edhe ato qytetëri janë të vjejtura e u bëjnë nder atyre q' i kanë pasurë. Ne vështrofshimë mirë e të mendohemi thellë, kupëtojëmë qe qytetaria rënjën e ka në kohëra fort të vjetra e të haruara në fund t' erësisë së motit; ay që gjeti të parënë herë qysh mbillet e koretë gruri, qysh turet [në] avlemendetë leshi, etj, ay vuri gurin e parë të qytetërisë; q' atëher' e tëhu qytetëria ka vajturë gjithënjë përpara herë me vrap e herë ngadalë. Qytetëria është një e-pandarë, po ata q' e kanë ruajtur' e q' e kanë ritur e xbukuruarë kanë qënë në ç' do kohë të tjerë; herë ka rënë në dorë të një kombi, herë në dorë të një tjatri, nga një herë ka qen' e-vrejtur' e-

veniturë, po kurë s'ka qën' e shuar fare; edhe me të qënë që të-parëtë kanë qënë kurdo mjeshtrit' e mësonjësit' e të-pastajmët, ç'do qytetëri m'e pastajme ka pasurë qënë m'egër' e m'e plotë nga m'e para, sikundre që qytetëri e Grekërvet, ish shumë m'e-mbarë nga qytetërit' e kombevet të-vjetërë t'Asis'e t'Egjyptësë edhe qytetëri e Arabëvet m'e mbarë nga Grekret, kështu edhe qytetëri e Evropjanëvet është m'e mbarë nga të-tëra të shkuaratë. Dy gjëra e çquajnë më tepërë qytetërin' e Evropjanëvet nga qytetërit' e vjetëra: e para që është m'e lentte se ato; e dyta që është m'e-përgjithçime e m'e përhapurë. Vërtet qytetërit e-vjetëra ishinë më tepër me fjalë se me punë; kishinë vivlla të-shuma e të mbëdha të shkruara me mendim të-thellë, po s'para kishinë punëra të-lentta që dukeshinë në shesh; nuk munt të themi se s'kishinë mjeshteri e punëra të dorësë, nga të-cilatë ca gjenden edhe sot edhe njeri s'mund t'i bënë dot; po ato punëra bëheshinë me dorë, me shumë mundim, në shumë kohë edhe ishinë të rralla e të-shtrenjta. Për të punuar s'kishinë përveç duart e sklevët të cilët i mbanin nënjë robëri të keqe edhe më shumë i vininë të punojënë me hekura në këmbë e në qafë. Për të punuarë tregërinë, s'kishinë përveç krahët' e dobët të kafshëvet edhe anijat që prisininë erënë për të ecurë.

Dituritë në kohërat e vjetëra kishinë vajturë shumë përpara, po nuk' aqë sa apënë pemë, pemënë po e apënë sot.

Fuqi e avullit e cila bënë të ecinë anijatë edhe të marënë në pakë kohë udhë shumë të-gjatë, e cila bënë të ecuritë mi udhë të hekurtë me një çpëjtim për të çuditurë, heq barë që s'e heqinë dot njëmij kuaj, e e-shpije në një ditë në vent që me kuajt s'vihetë në dy javë, e cila bënë që një kazan me ujë edhe ca copa hekurë të bëjnë në një ditë me të-madhe lehtësi pune që s'e bëjnë dot qinda njerës në shumë kohë; fuqi e avullit, thashë, që bënë gjithë këto çudi, edhe fuqi elektrikut i cili bënë të fluturuarët' e fjalësë në një çast nga një an'e dheut m'anë tjetërë, e i-cili ditë më ditë po tregon punëra më tepër' e më tepërë për të çuditurë, edhe i-cili një ditë do të zërë vendin e avullit; avulli e elektriku, them, edhe më shumë të tjera gjerra të këtilla, që s'u kishinë ardhurë fare në ment të vjetëret këto e bëjnë qytetërin' e sotme të jetë e-lentt' e vërtetë e të shquhetë nga qytetërit' e vjetëra.

Të gjendurit' e shtypshkronjësë është një nga më të mëdhat' e

udhëvet që kanë shpënë përpara qytetërin' e sotme. Qemoti vivllatë shkruheshinë me dorë në shumë kohë, me shumë mundim, ishinë foto të rralla e të shtrenjta, që s'muntninë t'il kishinë përveç të psuritë, edhe më të shumëatë ishinë të lathitura. Sot shtypshkronja shkel sa-kaqë-herë mijëra e qindëra mijërash vivlla, i përhap nëpër gjithë anët' te dheut e i bënë të shiten aqë lirë sa të muntnjë t'i marë kushdo edhe t'i këndonjë me lehtësi të madhe.

Shtypëshkronja e bëri diturinë të dalë nga duart' e të-pakëve e të përhapetë në për gjithë botënë ...

Qysh edhe kur u qytetëruanë Evripjanët të themi edhe mi këtë dy fjalë. Në kohëratë që kompet' e Asis' e t' Egjiptësësë ishinë të ndrituarë me një qytetëri të-mjaft si për ato kohë, edhe më pastaj kur vetëtinte qytetëria n' Athinë e së andejmi ndritte gjithanë anët rotull detit, n' ato kohëra Evropa ishte e' egër'; kombet' e Germanis' e të Francësë roninë nëpër stepa gjymësë-lakuriq si gjithë kombet' e egërë. Në këtë histori të shkurtërë të qytetërisë nuk zumë ngoje fare gje më tani emërinë' e Romanëve. Ky komp i-madh që vu ndënë vetëhe të-shumën' e botësë që dihesh atëherë, bëri shumë punëra të mbëdha, ca të lëvduara e ca të palëvduara, me të-cilatë është mbushurë historia; po ndonjë qytetëri s' diherë me emërit të-tyre. Këta nukë qenë njerës të pa-qytetëruarë, po me të që gjithë mendjen' e fuqin' e tyre e kishinë vënë në luftë e në ushtëri, nuk' u menduanë a nukë muntënë të bënin një qytetëri mevetëhe, edhe ranë pas qytetëris' së Grekërvet. Sado që gjuhën' e-tyre e shkruaninë edhe e shpunë shumë përpara, diturit' e-tyre i kishinë në gjuhëtë Greqisht. P' andaj qytetëri e romanëve munt të nëmërohetë një copë nga qytetëri e Grekërvet, si edhe qytetëri e Maqedonaset e Aleksandrionjët e nukë një qytetëri e ç' quarë në vetëhe.

Romanëtë eçuanë Evropën' e veriut e të perëndimit edhe e muarë nënë pushtetë të tyre i dhanë gjuhën' e-tyre, edhe kaqë qint vjet e-tër; Evropa s' kish tjetërë gjuhë për të shkruar' e për të kënduarë përveç Latinishtenë, gjuhën' e Romanëve.

Më pastaj u çkulë disa kombe të-egërë prej anëvet të veriut t' Evropës' e t' Asisë e u-hodhë përmi të gjith' anët' e Evropësë. Romanëtë që kishinë humburë vendet e Asis' e të Afrikësës, humpnë edhe Evropënë, edhe ata kombet' e-egërë si Hunëtë, Vandalëtë, Gotëret' etj. e mbuluanë të-tër' Evropënë. Atëhere u bë një nat' e thellë e erëtë, mbretëronte padia edhe egërsia, njerëzitë ishinë të-ndarë me dy, ca me duar të hekurta që vrisnin' e prisnin' e rëmbeninë si muntninë' e ca në hekura nënë zgjedhë që rënkoninë e nënë një skllavëri të keqe punoninë si kafshë e s' urdhëronin gjekafshë.

Me këtë mënyrë qe Evropa kur duall' Arabëtë, u hodhë nga Afria, e zunë Spanjën' e Portugalinë edhe gjysmënë' e Francësë, si e thamë në fjalët që bëmë përpara kësaj. Kombet' e e-gërë q' urdhëroninë Evropënë, me të qënë më të-poshtërë nga ata që kishinë nënë urdhërit të-tyre, muarë gjuhën' edhe besën' e këtyre edhe u përzienë me ta. Roma mbretëronte prapë mi gjith' Evropënë, po nukë me fuqi as me dituri, vetëmë me besë. Fuqi e besësë u bashkua me fuqin' e egërsisë edhe bënë një kohë të hekurit e të erësisë.

Dituri e grekërvet të-vjetërë edhe e atyre Romanëve ish fare e-paditurë n' Evropë, edhe emëri i këtyre kombeve ziresh ngojë me merzi si emër' i të

pabesë e i kombeve të mallkuarë.

Qytetëri e Arabëvet, në të cilët ish përtëriturë dituri e Grekërvet të vjetër vetëtinte me një dritë të çquarë në Spanjë, në Siqeli edhe nëpër gjithë anët të detit përkundraë Evropësë, po besa e padia u kish verbuarë sytë Evropësë, po besa e padia u kish verbuarë sytë Evropjanëvet, edhe kur ndodhesh nonjë që të vinte të mësonte diturit' e Arabëvet, priftëria e diqte të gjallë duke i marë për magistrice.

Më së fundi Arapëtë u pushtuanë në Spanjë, edhe priftëria dogji bashkë me njerëzitë gjithë vivllat' e tyre, e nga gjith' ajo qytetëri s' mbet as një shkëndijë ... Evropjanëtë, duke vajtur' e duke ardhurë n' Egjypt' e në Syri për të luftuarë suallë n' Evropë shumë gjëra të-vjejtura të-bëra prej arapëvet me shumë mjeshtëri. Tregëtarët' e Venetisë e të Gjenovësë me të parë këto plaçka, zunë të bënin një tregëti të-paprerë me Syrin' e me Egjyptënë. Pas tregëtisë erth edhe dituria; shkronjat' e Avisenit, të Albugazit e të tjerë të diturë arabë zunë të ktheheshinë në latinishte, edhe të mësohenë kaqë kohë nëpër gjithë shkollat' e Evropës. Nga shkronjat e Arabëvet Evropjanëtë mësuanë edhe emërat e shkronjavet të Grekëvet të-vjetërë. Mëpastaj ku u muarë Kostantinopoja, shumë Grekër' ikën' e vanë nëpër anët e Italisë, e u mësuanë Evropjanëvet shkronjat e Grekërvet të vjetërë.

Kështu zunë Evropjanëtë të ndritoheshinë me dituri, po shumë kohë s' bënë dot një gjurmë më tej diturivet t' arabëvet. Galileja, Kepleri, Koperniku, Neftoni e të-tjeër të diturë të-mbëdhenj e hodhë këtë shteg edhe e zgjeruanë shumë diturinë duke gjeturë shumë të vërteta përmi diturit të qjejet e të matematikavet.

Në vendet të gjuhës latinishte cilido komp zu të shkruajë gjuhën' e tij; kjo edhe çpikje e shtypshkronjësë bënë të përhapetë përnjërshë dituria nëpër gjithë njerëzit' e kombevet; çpikjet' e gjendjetë zunë t' arrinjënë njëra pas tjetërës. Priftëria e kisha u ndejti shumë kohë kurndreq e i tëmeronte ata që përpiqeshin për të diturit. Më në fund arinë filozofë të mëdhenj si Volteri, Rusoj, Dekarti edhe shumë të-tjerë të-cilëtë i hapnë udhë mendimit të pa-penguarë edhe e muntënë për gjithë jetënë priftërinë edhe i hapnë udhë të-gjerë dituris' e qytetërisë, në të cilënë qytetëria po vete sa mbar' e e më mbarë edhe po përhapetë ditë me ditë nëpër gjithë anët' e dheut, e po shtohet' e zgjerohetë.

Kjo qytetëri e-vertetë, e-përgjithshime, e-përjetshime, e-pavdekurë. Si lum ata kombe që janë ndrituarë a që përpiqenë të ndritohenë me këtë qytetëri.

Botuar më 1885

"Dituria"

Sami FRASHERI,

Dituria është që e bën njerinë të quhet njeri e të çquhetë nga të gjithë kafshët'e- tjera, të cilatëë lëvizin dhe ecin'e han'e pinë edhe ato si edhe njeriu. Sa do mënt të tepër të ketë njeriu nukë munt kurrë të dijë prej vetiu gjithë të vërtetat dhe gjithë ç'i duhetë të dijë as me të dëgjuar'e me të parë munt të bëhetë njeri i - diturë, as edhe me të vuarë, se jet' e njeriut është e-pakë. Gjithë ç'kanë mundurë të mësojnë, të kupëtojnë a të çpikinë, njerëzit që kanë shkruar për - mi dhet përpara nesh që nga mijëra vjet e tëhu, gjithë ç'ka ngjarë, gjithë ç'është bërë e gjithë ç'janë munduarë njerës të urtë e me mënt tepërë, gjithë ç'kanë par'e ç'kanë vuar' ata që kanë vuajturë në-për vende larg'e të-pa-di-turë, me nj fjalë gjithë çka ngjarë në jetët, gjithë ç'ka çpikur'a mbledhur njeriu dhe gjithë ç;ka gjeturë në natyrat, të gjitha janë të shkruara dhe këto bëjnë të diturin'e njeriut, e - cila s'fitohetë për-veçse nëmësim. Pr'andaj, munt të themi se dituria është mësimi, edhe i pa-mësuar i s'munt kurrë të jet'i-diturë. I mësuar di ç'është bërë që nga krey i jetës'e tëhu; di ç'ka mbi dhet e nënë dhet, di ç'është dheu, çështë qielli, ç'është natyra, ç'është vetë, di ç'do që munt të dihet, edhe kupton ç'do që munt të kopëtohetë. I pamësuar s'di përveç ç'sheh me sy e ç'dëgjon me veshë; për atë jeta niset edhe soset me gjalljet të ti, nuk di as ç'është bërë me parë tij, as çmunt të bëhetë ps tij; për atë dheu është aqë sa e sheh ay edhe qielli ashtu siç e sheh ay:

Pleqtë tanë thoshin " mos pyet të mësuarënë, po të vuarënë". Ajo fjalë ishte e-drejtë për atë kohë, në të cilënë mësimi e dituria nuk ish tjetërë gjë për-veç mësimi i besësë a shumë shumë.e i nonjë gjuhe të huaj. Po të jetashtu, vërtet mësimi nukë zë dot vendin e vuajtjes, po sot në ditë tënë mësimi e dituria janë shumë më të gjera e më të forta se ç'pandeheshin atë-herë. Sot për sot nëpër vendet e qytetuarë dituria është si djellë që mbulon me dritat e me shkëndiat të ti gjithë ç'është, e s'lë errësirrë gjëkunt. Mësimi në ato vende nuk është vetëmë për besët, as vetëmë për të mësuarë gjuhë, po për të ndritunë mëndjenë me ç'do farë diturie. Gjithë ç'mësohetë sot është shkruar nga njerës jo vetëm të diturë por edhe të vuarë. Sot nuk ka neri m'i vuarë se i-mësuar, se ay di' jo vetëmë ç'ka vuarë vetë, po edhe ç'kanë vuarë mijëra njerës përpara tij. Për dy gjëra i duhet njeriut dituria. E para të marrë vesh e të kuptojë gjithë ç'i sheh syri, ç'i dëgjon veshi, ç'i zë dora, ç'i shkel këmba edhe gjithë ç'i vjen ndër mënt; të dije se ç'është, ç'ka qenë, ç'dotë bëhetë, ku është, nga ka ardhurë, ku do të vejë. E dyta, të muntnjë të fitojë sa më tepërë e të ronjë sa

më mirë, jo vetëmë duke u bërë shkronjës a nënurdhrës, po më tepërë e të ronjë sa më mirë, jo vetëm duke u bërë shkronjës a nënurdhrës, po më tepërë duke nxjerrë nga dheue nga natyra gjëra të vjejtura, me të cialtë edhe ay edhe gjithë njerëzia të mundinë të bëjnë shumë punëra, e duke gjeturë ç'do farë udhe e çdo farë lehcije, për të vajturë njerëzia sa mbar' e më mbarë. Mundimë të themi që e par'e këtyre dy shërbimeve, që pret njeriu nga dituria, është e palënttë, e dyta e lenttë. Vërtet njeriu është mbujturë me një natyrë, e cila e ç'pon të kërkonjë, të pyesë e të dojë të marrë vesh ç'do gjë, do të dijë jo vetëmë ç'i duhet, po edhe ç'do gjë; do të dijë vetëmë për të diturë. Këtu është çquarj' e njeriut nga kafshët e tjera; po i varfëri njeriu i paditurë është mësuarë të mos pyesë e të mos kërkonjë shumë gjëra që duhesh t'i pyette e t'i kërkonte më parë se çdo gjë. Kur shohim një njeri që shkon udhësë, na ha zëmëra e pyesim e të mos dimë se na vetë, ç'jemi, nga kemi ardhur e ku do të vemi? Qysh të mos dimë ç'kemi brenda në trup tënë, si jemi gjallë, ç'është ky gjak që punon nëpër rembat e trupit tënë, si shohëmë, si dëgjojmë? Qysh të mos pyesim pse bëhetë natë, pse hapetë dita, ç'është dielli, ç'janë këta yj, ç'është ky shi që bije pika-pika, nga vjen gjëmimi, nga del vetëtima, nga bije rufeja? Si cilido, kur ka qenë foshnje, me të zënë të flasë, më parë se ç'do gjë, këto ka pyeturë, po duke parë se të mëdhenjtë qeshinë me këto pyetje të ti, e duke marë vesh që as s'i dininë, është mësuarë edhe ay ti shoh e të mos i pyesë, t'i dëgjonj e të mos i dijë. Dituria vetëmë munt të përgjigjetë me gjithë këto pyetje, të përgjigjetë duke rëfyerë ç'do gjë. Kjo është njëra faqe e diturisë. Të vimë në faqet tjetërë, në anët të lentë, si thamëmë sipër. Dituria sot i duhet ç'do njeriu, jo vetëmë që të muntnjë të shkruanjë a të këndonjë një kartë a të mbledhë pesë numura, si pandehesh më parë, më parë, jo vetëmë që ti tregonjë gjithë të vërtetat, si thamë më sipërë, po edhe që ndihnj'e e ti aëpë dorënë në punët që do të punonjë për të rojturë. Edhe bujku që lëron arënë, edhe bariu që ruanë bagatinë, dhe ç'do punëtor që bën një punë, ka nevojë për dituri, sepse i tregon një mijë urdhëra për të punuarë më lehtë më mirë e për të fituarë më tepërë. Qytetëria i ka holluarë aq punërat sa dor' e-ashpërë dhe mëndj' e-pa gdhendur'e të pa-diturit nuk mund të punonjë gjë të pëlqyerë. Në qytetëri' të-sotme nuk janë vetëmë mësonjëtorët për të dhënë dritë botësë po janë çpikurë edhe shumë udhëra të-tjera, me të cilat u epet dritë edhe atyre që s'kanë vërsën (moshën) e të vajturit në mësonjëto, tregohen' edhe shumë të vërteta të cilat s'mësohenë dot në mësonjëto sa duhet. Një nga këto urdhra janë edhe fletoretë që flasënë për dituri, si edhe kjo kjo Drita, e-cila do të flasë për ç'do farë diturie, në mënyrë që të ëmbëlsohet prej saj, i-madhi e i-vogëli edhe secili do të gjenjë brenda, në të një gjë që t'i vlenjë që diç t'i mësonjë a t'a xbavitnjë.

Botuar në vitin 1884

Shqiperia c'ka qene,c'eshte, e cdo te behet ?

Permbledhje nga vepra :Shqiperia c'ka qene,c'eshte, e cdo te behet ?

Autori : Sami Frasheri

... Nje komb i vjeter, me i vjetri i kombeve te Evropes,Pellazget e qemocem te mbajtur e te qendruar qe prej mijera vite ne roberi ishin, nje komb kaq i vjeter e me gjithese kesaj fort i ri, qe tani po ze te lulezoje per te paren here,nje komb trim e i zoti me nje koke e me nje balle, qe s'i ka askush tjetër, me nje gjuhe te gjere e te plote, te bukur e te lehte, qe e meson qe ne gjirin e nenes, nje komb te tille, kush mund ti dale kuner, e kush mund t'i shkoje perpara ?

O burrani, o Shqiptare! Nqs duam e nqs perpiqemi do te jemi nje nga me te miret e nga me te ndriturit e kombeve te Evropes qe te na kene zili gjithë bota. O burrani! Te mos na mbuloje gjumi i mefshtesise e ti paditurise, sepse nqs rrimë keshtu ,jemi te humbur.Oh! Sa me dhimbje e madhe e sa turp i rende te humbase sot,ne kete kohe qe edhe me te dobetit e kombeve kane gjuhen e tyre dhe po lulezojne, nje komb si i shqiptareve qe eshte mbajtur per mijera vite ne roberi, ne kohera teper te egra. Nje komb kaq i mencur, me nje gjuhe te bukur te humbase nga padija e nga mos pasuri nje gjuhe te shkruar! Nje komb kaq trim e qe se kursen gjakun te humbase duke u copetuar prej kombeve te dobet e te frikshem! Mend kemi,trimeri kemi,gjuhe te bukur e te lehte kemi, ete mos dime a te mos duam t'i perdorim gjithë keto per te miren tone, po te rrimë me duar lidhur ,kjo eshte me ekeqja,te punojme per humbjete tona, te nxjerrim themelet e kombit tone me padituri e te verberve te vete ?! A jemi shqiptare? Besa, feja, puna,kujdesi, deshira jone, mendimi yne te jete per Shqiperine e per shqiptarine. Te cojme gjuhen perpara, ta zgjerojme e ta zbukurojme me shkronja e me dituri; te hapim shkolla , te mesojme, te mos mbese ndonje shqiptar i paditur e qe te mos dije te lexoje e te shkruaje ; te largojme shkollat e huaja nga Shqiperia e ta mbushim memedheun tone me shkolla shqipe;djemte tane ne nje kohe te shkurter te mesojne te lexojne e te shkruajne gjuhen e tyre edhe diturite qe u duhen ; meqenese gjuhen e dine vetvetiu e mundin ta mesojne ne pak kohe, do te kene deshire te mesojne mjaft dituri ; edhe bariu dhe bujku edhe mjeshteri i mureve nuk do mbetet pa dituri.

Keto pune jane te drejtat tona ; kush te mos na lere te punojme ne kete udhe

te se drejtes e te miresise, na ka rembyere te drejten nga dora jone; eshte drejta jone te perpiqemi me fjale , me pene, me arme , qe te shkeputim te drejten tone nga thonjte e atyre qe na e kane rrembyer. Nuk duam te rrembejme gjene e tjetrit, por s'duam te leme edhe gjene tone e te drejten e sheshit te na e rrembejne me pahir. Te perpiqemi per te drejten tone, per gjuhen tone, per kombin tone, per te miren e kombit tone; kush te na qendroje perpara e te na ndaloje ne kete udhe te shenjte, te therrasim, te na degjojne bote e qytetare, te na ndihmojne edhe ata ne te drejten e bekuar, qe duam te mbrojme. Te mos trembemi nga asgje, te perpiqemi qe mos te pushojme deri sa te fitojme ate qe kerkojme; jemi ne te drejten tone; Perendia eshte gjithnje ndihmesi i te drejteve, Perendia eshte e drejta vete !

O vellezer shqiptar ! Te mos na ndodhi si atyre te egerve te Australise e te Afrikes, qe vendet Evropiane i genjejne me ca rruaza e me ca dragole te qelqta e me pasqyra te pafillta e u marrin vendin e tyre nga dora. Te mos genjehemi edhe ne ashtu me ca copa pafillesh e qelqesh, qe s'vlejne asnje gje, e te leme te drejtat e kombit e te memedheut tone ne duar te te huajve e te armiqeve tone. Te thyejme zgjedhen e huaj , qe po na shtrengon kembet, te hidhemi me siper hijes se rende, qe po na shkel e po na shtyp e s'na le te marrim fryme ! Te mos rrim te mpire e te ngrire, te levizim duar e kembe, te tundemi e te lekundemi, te ecim te lire ne udhen e Perendise, ne udhe te se drejtes :

PERENDIA, E DREJTA, KOMBI, GJUHA !
sHQIPERIA, sHQIPETARIA !

Ja qellimi yne! Ja puna jone e shenjteruar ! Ja besa jone ! Te gjithë ata qe kane kete qellim , jane vellezerit tane ! Ne mesin e Shqiptareve te vertete s'ka ndonje ndarje, ndonje percarje, ndonje dyshim ! Jane te gjithë vellezer. te gjithë nje trup , nje mendje, nje qellim, nje bese !

U pershtat nga une ne gjuhen Letrare Shqipe te diteve te sotme